



**Prishtinë: 22.04.2013**

**Kodi i ZRRE-së: V\_523\_2013**

**Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_903\_02\_13**

### **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kreu IV, nenit 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_903\_02\_13**; dhe
5. Ankesën e konsumatorit me datë 14.03.2013.

**Në mbledhjen e mbajtur më 22 prill 2013, nxorri këtë:**

### **VENDIM**

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A.B. (shifra në KEK: DFE - 9011256) nga Ferizaj ndaj vendimit të DMK-së, si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK\_V\_903\_02\_13 i datës 19.02.2013.

### **Arsyetim**

Me datë 16.06.2011 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar që konsumatorit i vendoset për matje njehsori elektrik I KEK-ut me nr. 47553294.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për ndërrim njehsori me datë 20.06.2011 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë regjistruar të dhënat teknike të njehsorit elektrik nr. 47553294 të vendosur nga ekipi i KEK-ut me datë 16.06.2011, si dhe kanë evidentuar të dhënat e njehsorit nr. 10541214 të larguar nga pika matëse. Pas kësaj me datë 02.05.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit “Ç. D.” me shifër DFE 9003791, dhe kanë konstatuar se konsumatori ka larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 256754. Ekipi i KEK-ut ka evidentuar që konsumatori ka bërë kyçjen në njehsor tjetër andaj borxhi duhet t’i bartet në shifrën DFE - 9011256.

Me datë 15.05.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit A. B. me shifër DFE – 9011256, dhe kanë konstatuar se kanë bërë vulosjen si dhe kontrollimin e njehsorit elektrik.

Punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse të konsumatorit bazuar në procesverbalin numër 0971745 të datës 02.05.2012 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DPR – 9003791, ku kanë konstatuar se konsumatori ka larguar nga pika e matjes njehsorin elektrik numër 256754 si dhe lokali është shndërruar në objekt banimi dhe shfrytëzon vetëm një njehsor elektrik. Ekipi i KEK-ut po ashtu ka evidentuar që borxhi duhet t’i bartet nga shifra DFE 9003791 në shifrën DFE 9011256.



Departamenti i faturimit në KEK me datë 21.05.2012 përmes urdhër lejimit/ngarkimit numër 19134 ka bërë transferimin e borxhit nga shifra DFE 9003791 në DFE 9011256 në vlerë 256.28€. pas kësaj ngarkese të bërë nga KEK-u, konsumatori me datë 10.07.2012 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar transferimin e borxhit nga shifra DFE 9003791 në DFE 9011256 të datës 21.05.2012. Departamenti për Konsumator në KEK pas ankesës së bërë nga konsumatori ka shqyrtuar lëndën e konsumatorit dhe ka refuzuar ankesën e tij. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes nga ana e KEK-ut, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE me të cilin ka kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka bërë shqyrtimin e ankesës së konsumatorit dhe me datë 19.02.2013 ka nxjerr vendim duke refuzuar ankesën e konsumatorit.

Pas marrjes së vendimit të DMK-së, më datë 14.03.2013 konsumatori ka parashtruar ankesë në Bordin e ZRRE-së, me të cilën ka kundërshtuar vendimin e DMK-së nr. ZRRE/DMK\_V\_903\_02\_13 të datës 19.02.2013. Konsumatori në ankesë thekson se nuk pajtohet me vendimin e DMK-së pasi që nuk është e vërtetë se gjatë ardhjes së inkasantit për të lexuar gjendjen nuk ka gjetur njehsorin ngase të dy njehsorët janë marrë nga KEK-u pa prezencën e tij. Pasi janë marrë njehsorët nuk është bartur borxhi menjëherë te personi që ka punuar por pas një kohe pasi që e ka shëndrruar dyqanin në hapësirë banimi ku edhe jam duke jetuar.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 22.04.2013 ka shqyrtuar dhe analizuar dëshmitë e paraqitura nga konsumatori, përkatësisht kundërshtimet e konsumatorit të theksuar në ankesë ndaj vendimit të DMK-së.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar procesverbalet e KEK-ut nr. nr. 1060744 të datës 16.06.2011, nr. 0023 të datës 21.02.2008, nr. 0971745 i datë 02.05.2012 dhe nr. 1570469 i datës 15.05.2012 dhe ka vërejtur në procesverbalin nr. 1060744 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit me shifër DFE - 9011256 dhe gjatë inspektimit kanë evidentuar që konsumatorit i vendoset për matje njehsori elektrik i KEK-ut me nr. 47553294 si dhe kanë vulosur me vulë distributive numër C70017858. Ky procesverbal nr. 1060744 është përpiluar në emër të A. B. me adresë "R. B." si lokal. Edhe vërtetimi i KEK-ut nr. 0023 për ndërrim njehsori ku edhe është bërë ndërrimi i njehsorit elektrik është përpiluar në emër të A. B. me adresë "R. B." në shifrën DFE – 9011256. Në procesverbalin e KEK-ut nr. 0971745 të datës 02.05.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit "Ç. D" me shifër DFE - 9003791 ku kanë konstatuar se konsumatori ka larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 256754. Ekipi i KEK-ut ka evidentuar që konsumatori ka bërë kyçjen në njehsor tjetër andaj borxhi duhet t'i bartet në shifrën DFE 9011256. Duhet theksuar se punëtorët e autorizuar të KEK-ut si në procesverbalin nr. 0971745 të datës 02.05.2012 ashtu edhe në raportin e inspektimit rastet kanë dështuar që të evidentojnë njehsorin e vendosur për matje si dhe në marrjen e masave të parapara me procedura për kontrollimin e energjisë elektrike të shpenzuar nga konsumator.

Bordi i ZRRE-së ka analizuar rrjedhën e energjisë elektrike si dhe transaksionet e konsumatorit A. B. me shifër DFE 9011256 dhe konstaton se konsumatorit nga fillimi deri në periudhën 05/2011 shpenzimet e energjisë elektrike i janë regjistruar në njehsorin elektrik numër 10541214 ndërsa nga periudha 06/2011 e tutje në njehsorin elektrik numër 47553294. Sipas rrjedhës së energjisë nga periudha 08/2007 deri në periudhën 12/2009 nuk ka fare shpenzim të energjisë elektrike ndërsa për periudhën 01/2010 dhe 03/2010 konsumatori është ngarkuar pa matje, për periudhën 04/2010 është faturuar me matje dhe nga periudha 05/2010 deri më 09/2010 nuk ka fare shpenzim të energjisë. Po ashtu janë analizuar edhe rrjedhat e energjisë elektrike si dhe transaksionet e konsumatorit "Ç. D." me shifër DFE 9003791 dhe është vërejtur se konsumatori nga fillimi deri në periudhën 05/2011 nuk ka fare shpenzim të energjisë elektrike kurse për periudhat 07/2004, 08/2004, 10/2004, 11/2004,



11/2007,03/2008 është ngarkuar pa matje/paushall kurse për periudhën 10/2008, 11/2008, 06/2009, 07/2009 dhe 12/2009 me matje. Sipas kartelës së konsumatorit me shifër DFE 9003791 po ashtu konstatohet se konsumatori gjatë tërë periudhës së faturimit 08/2002 deri më 05/2012 nuk ka pagesa të shpenzimit të energjisë elektrike përveç periudhës 23.01.2003 kur është bërë pagesa në vlerë 61€. Sipas analizave të transaksioneve në dy shifrave DFE 9003791 dhe DFE 9011256 konstatohet që me datë 13.06.2009 në shifrën DFE 9003791 është bërë pagesë e energjisë elektrik DFE09MC061264986/125 në vlerë 200€ e cila pastaj të njëjtën ditë është anuluar dhe bartur si pagesë e rregullt DFE09MC062226329/15 në shifrën DFE 9011256.

Janë analizuar edhe listat e leximit të KEK-ut të shifrave DFE – 90011256 dhe DFE – 9003791 prej periudhës 06/2010 deri më 06/2011 dhe se në disa lista të leximit lexuesi ka evidentuar se lokali nuk punon dhe nuk ka çasje në lexim, e disa lista ka evidentuar se nuk ka shpenzim dhe nuk ka çasje në lexim, e në disa raste ka evidentuar se ka shpenzim por mungon vula distributive.

Bordi i ZRRE-së, ka vlerësuar se parashtruesi i ankesës A. B. në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së, nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj. Kundërshtimet që janë dhënë në ankesë nuk i referohen se cilat dispozita ligjore janë shkelë nga ana e DMK-së, gjatë nxjerrjes së vendimit, gjithashtu kundërshtimet të theksuara në ankesë kanë shumë kundërthënie njëra me tjetrën, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së pas analizimit të gjitha proceseve të KEK-ut, dhe ankesës së konsumatorit konstaton se Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE ka vepruar drejt në vendimin e tij.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 22.04.2013 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK\_V\_903\_02\_13, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

#### **Bordi i ZRRE-së**

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar